REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR.752 REP. NR.272 KOL.

Taksa e u paguar

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 21.02.2019 (dymije e nentembedhjete) para meje Noteres **Margena Çela** me seli ne Bulevardin "Gjergj Fishta" u paraqiten personat e meposhtem:

SHITESI: Shefqet Dizdari, lindur me 23.12.1955 ne Tropoje dhe banues ne Rrugen "Sami Frasheri, Tirane me pasaporte nr. BD3069611, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, Ortak i Vetem i shoqerise "Lawoffice &Investigation" shpk

BLERESIT: 1. **z. Charles Franklin MC Gonigal,** shtetas amerikan me pasaporte nr. 572237962 banues ne New York, SHBA, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,
2. **z. Mark Thomas Rossini**, shtetas amerikan me pasaporte nr. 548463601, banues ne New York, SHBA, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar
3. **z. Agron Neza**, zoterues i pasaportes amerikane nr. 491549180, banues ne New York, SHBA, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Personat e mesiperm, te cilet ne vazhdim te kesaj kontrate do te thirren shkurt "Shitesi" dhe "Bleresit", me kerkuan perpilimin e kesaj kontrate si me poshte vijon:

Sipas Ekstraktit te QKR, shoqeria "Lawoffice &Investigation" shpk., eshte regjistruar me date 10.01.2008 si person juridik per te ushtruar aktivitetin e saj ne fushen e investigimeve, etj. dhe mban numrin e identifikimit K81310029E.

Zoti Shefqet Dizdari eshte Ortak i Vetem i shoqerise "Lawoffice &Investigation" shpk dhe deri ne kete moment zoteron 100% te kapitalit te saj ose 1 (nje) kuote. Sot, me vendimin e Ortakut te Vetem date 21.02.2019, numri i kuotave te shoqerise "Lawoffice &Investigation" shpk eshte rritur nga 1 (nje) ne 4 (kater) kuota.

Me vullnetin e tij te lire e te plote Shitesi **z. Shefqet Dizdari**, me cilesine e Ortakut te Vetem qe zoteron 100% te shoqerise "Lawoffice & Investigation" shpk ose 4 (kater) kuota, i shet Bleresve, z. Charles Franklin MC Gonigal, z. Mark Thomas Rossini, dhe z. Agron Neza perkatesisht nga 25% te kapitalit qe ai aktualisht zoteron ne kete shoqeri apo nga 1 kuote te kesaj shoqerie secilit duke u bere Bleresit ortake te rinj ne shoqerine "Lawoffice & Investigation" shpk dhe duke zoteruar secili nga 1 te kuote te kesaj shoqerie. Çmimi i shitjes per 1 kuote te kapitalit te shoqerise "Lawoffice & Investigation" shpk. do te jete 1 (nje) dollar amerikan.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate shitje, **z. Shefqet Dizdari, z. Charles Franklin MC Gonigal, z. Mark Thomas Rossini** dhe **z. Agron Neza,** behen ortake te Shoqerise "Lawoffice & Investigation" shpk. ne masen perkatesisht 25% secili dhe perfaqesuesi ligjor i shoqerise se mesiperme do te jete z. **Charles Franklin MC Gonigal.**

Bleresit, **z. Charles Franklin MC Gonigal z. Mark Thomas Rossini** dhe **z. Agron Neza,** pranojne secili blerjen e 25% te shoqerise "Lawoffice & Investigation" shpk, ose nga 1 kuote te kesaj shoqerie nga zoteruesi i meparshem z. Shefqet Dizdari, dhe deklarojne se e kane likujduar Shitesin jashte kesaj zyre.

Kjo kontrate shitje u perpilua ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil dhe te ligjit "Per Noterine" si edhe te ligjit nr.9901 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Kjo kontrate shitje pasi iu lexua paleve kontraktuese ne pranine e perkthyeses te gjuhes angleze Edlira Kaliaj, e kuptuan ate dhe e gjeten sipas vullnetit te tyre te lire e te plote e nenshkruan rregullisht ne prani te Noteres dhe une Noterja e vertetoj kete sipas ligjit.

PALET

SHITESI

Shefqet Dizdari

LAWOFFICE & INVESTIGATION STUDIO - LIGJORE Av. Shefqet DIZDARI TIRANE NUIS: K81310029E

BLERESIT

Charles Franklin MC Gonigal

Charles F. McGonigal

Mark Thomas Rossini

MARK T. ROSSINI

Agron Neza

AGRON NEZA

NOTERE

NOTERE MARGENA ÇELA Cel: 069/52 44 272

NOTER TIRANE